

VENDIM
Nr.596, datë 5.9.2007

PËR NGRITJEN E STRUKTURAVE DHE PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE E TË PËRGJEGJËSIVE PËR ZBATIMIN E INSTRUMENTIT TË PARAZGJERIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Integritimit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Strukturat, autoritetet dhe përgjegjësitë për zbatimin e Instrumentit të Parazgjerimit (IPA) janë, si më poshtë vijon:

a) Ministri i Integritimit caktohet Koordinator Kombëtar i Instrumentit të Parazgjerimit (IPA) dhe do të udhëheqë procesin e programimit të fondeve të Bashkimit European.

b) Ministri i Financave caktohet zyrtar përgjegjës akreditues dhe është përgjegjës për monitorimin e plotësimit të kërkesave për akreditimin e zyrtarit kombëtar të autorizuar dhe të fondit kombëtar.

c) Zëvendësministri i Financave caktohet zyrtar kombëtar i autorizuar dhe njëkohësisht, është edhe kryetar i fondit kombëtar.

ç) Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave caktohet zyrtar i autorizuar i programit.

d) Njësia e financimeve dhe e kontraktimeve, në Ministrinë e Financave, shërben si njësi qendrore për financim dhe kontraktim.

dh) Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit shërben si fond kombëtar dhe është përgjegjëse për menaxhimin financiar të asistencës së programit IPA.

e) Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit shërben si autoriteti i auditimit dhe është përgjegjëse për verifikimin e funksionimit efektiv të sistemit të kontrollit dhe menaxhimit të zbatimit të programit IPA.

2. Ministria e Integritimit identifikon përparësitë për financim nga programi IPA, në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore. Për përparësitë e identifikuara bëhen keshillime me Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj dhe Ministrinë e Financave dhe më pas i paraqiten për miratim Komitetit të Planifikimit Strategjik. Ministria e Integritimit u përcjell Shërbimeve të Komisionit European përparësitë, të miratuara për financim nga Komiteti i Planifikimit Strategjik.

3. Njësia e menaxhimit të projekteve për programin e zhvillimit të komuniteteve vendore, në varësi të Ministrisë së Integritimit, transferohet në Ministrinë e Financave. Kjo njësi rristrukturohet, në përputhje me rolin e funksionet e njësisë qendrore për financim dhe kontraktim.

4. Zbatimi i programit të zhvillimit të komuniteteve vendore do të bëhet sipas strukturave dhe autoriteteve të përcaktuara në këtë vendim, për zbatimin e Instrumentit të Parazgjerimit (IPA).

5. Ngarkohet Ministria e Integritimit, nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, të kryejë programimin e fondeve të Bashkimit European, për programin e zhvillimit të komuniteteve vendore.

6. Ngarkohen Ministria e Integritimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

7. Urdhri nr.154, datë 13.7.2006 i Kryeministrit “Për caktimin e koordinatorit kombëtar në programin “Instrumenti i Ndihmës së Paraaderimit” të Bashkimit European”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha